



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësi: Unit:	2K	Nr. Prot.: Prot. No.:	127/2019
Jedrinca: Branch:		Br. Prot.: Br. Prot.:	
Nr. i faqeve: No. of pages:	- 01 -	Data: Date:	31.01.2019
Br. shtyllat: Br. stencils:		Datumi: Date:	
Prishtinë			

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 127/2019

PËR: Mjekët në specializim

NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci, Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës

LËNDA: Qarkore njoftuese lidhur me obligimin e rilicencimit për mjekët në specializim

Datë: 30 janar 2019

Të nderuar mjek specializant,

Secili anëtar i Odës, respektivisht mjeku, është i obliguar që t'i nënshtrohet edukimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e kujdesit mjekësor dhe të plotësojë kushtet për rilicencim. Anëtar i Odës është i obliguar që brenda 5 (pesë) viteve të grumbullojë në total 100 (njëqind) pikë për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së ashtu që çdo vit të fitojë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) pikë dhe maksimum 25 (njëzet e pesë) pikë, sipas listës së pikëve, duke e llogaritur nga data e lëshimit të licencës së fundit për punë.

Megjithatë në Kuvendin e mbajtur me datë 17 janar 2019, është vendosur që të gjithë mjekët që janë specializant në lëmi përkatëse, të lirohen nga obligimi i grumbullimit të 100 pikëve për procedurën e rilicencimit, kjo vetëm gjatë periudhës së rregullt të edukimit specialistik.

Rrjedhimisht cdo mjek në specializim, me licencë të skaduar të punës është i obliguar që të inicioj procedurën për rilicencim si doktor i mjekësisë direkt pranë Komisioni për Licencim. Me parashtrimin e aplikacionit dhe dokumenteve gjegjëse duhet të dorëzohet edhe kopja e vendimit për lejim të specializimit në bazë të të cilit lëshohet licenca e punës për periudhën e caktuar kohore deri në nënshtrimin të provimit specialistik.

Licencimi, respektivisht rilicencimi i mjekëve është i detyrueshëm për të gjithë mjekët për ushtrimin e veprimtarisë mjekësore sipas autorizimeve ligjore dhe vetëm mjekëve me licencë valide të punës i dorëzohet faksimili i cili shërben si shenjë e identifikimit profesional.

Me respekt,

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci
Kryetar i OMK-së

